

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik “Për miratimin e planit të masave për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2026” të bashkisë Durrës.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me “Miratimin e planit të masave për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2026 të bashkisë Durrës”.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Durrës në datë 25 Maj 2026, ora 12:00.

Sugjerimet/komentet/rekomandimet janë të mirëpritura deri më datë 25 Maj 2026, në adresat e emailit:

Daniela.Murataj@durres.gov.al, Ornela.Marku@durres.gov.al, keshillidurres@gmail.com

Pjesëmarrës:

- Këshilli Bashkiak dhe Administrata e Bashkisë Durrës.
- Banorët e Bashkisë Durrës, pjesëmarrës nga Njësitë Administrative të bashkisë Durrës, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, përfaqësues të komuniteteve fetare në Durrës, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.,

Forma e konsultimit: Takim publik dhe postë elektronike.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik synon përfshirjen e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me inspektimin, parandalimin, shuarjen e zjarreve, mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, si dhe zvogëlimin e riskut kur ndodhin këto zjarre. Qëllimi i këtij plani është të sigurojë një qasje të koordinuar, të organizuar dhe efektive për parandalimin, menaxhimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor dhe kullor të bashkisë Durrës, duke minimizuar rrezikun për mjedisin, jetën e njerëzve dhe pasuritë materiale. Nëpërmjet këtij plani synohet forcimi i kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimit ndërmjet strukturave përgjegjëse, përmirësimi i sistemit të parashikimit dhe monitorimit të rrezikut nga zjarret, si dhe rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për mbrojtjen e burimeve natyrore. Plani ka për qëllim gjithashtu të garantojë reagim të shpejtë dhe efikas në rastet e emergjencave, duke përcaktuar qartë rolet, përgjegjësitë dhe procedurat e ndërhyrjes për të gjitha strukturat përfshirë, si dhe duke kontribuar në reduktimin e dëmeve dhe rikthimin e gjendjes normale në zonat e prekura.
------------------------------	--

Përshkrimi i çështjes.	<p>Në kuadrin e transferimit të pyjeve dhe kullotave pranë Bashkive, struktura përgjegjëse harton këtë plan të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2026 duke u bazuar dhe në analizën e shkaqeve të zjarreve si dhe në faktorët që influencojnë në shkaktimin dhe përhapjen e zjarreve në territorin e bashkisë. Bashkia Durrës ka një reliev fushor dhe kodrinor, pyjet në territorin e bashkisë tonë janë pyje të ulët, kryesisht cungishte e shkurre dhe shtrihen në zonën kodrinore. E gjithë zona që përfshihet brenda territorit administrativ të bashkisë është një rrezik për rënien e zjarreve në pyje dhe kullota. Shuarja e këtyre zjarreve është bërë nën drejtimin e personelit të M.Z.SH.-së Durrës. Në disa parcela me pyje dhe kullota nuk është e mundur të ndërhyhet me mjetet zjarrfikëse për shkak të terrenit dhe relievit natyror por ndërhyhet vetëm me fuqi punëtore apo vullnetarë ose nga ajri. Në rastet kur zjarri është pranë fshatrave, mjetet zjarrfikëse qëndrojnë në gadishmëri pranë banesave. Periudha e rënies së zjarreve në fondin pyjor e kulloror zakonisht është nga 15 Qershor deri më 15 Tetor. Pavarësisht nga përcaktimi i kohës së rënies së zjarreve, nuk përjashtohet mundësia e shfaqjes së tyre dhe në periudha të tjera, gjithmonë në varësi të kushteve atmosferike dhe ndikimit nga dora e njeriut.</p> <p>Në rast të shfaqjes së zjarreve në pyje e kullota do të organizohet i gjithë personeli pyjor, emergjencat civile, Njësitë Administrative së bashku me skuadrat zjarrfikëse, vullnetare të ngritura më parë në bazë fshati me mjete të ndryshme dhe do të jenë të pranishme në vend ku do të punohet për izolimin dhe shuarjen e zjarreve.</p>
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit më poshtë, brenda datës 25 Maj 2026.</p> <p>Daniela.Murataj@durres.gov.al, Ornela.Marku@durres.gov.al keshillidurres@gmail.com</p>
Projekt-vendimi, relacioni shoqëruar, në lidhje me çështjen që konsultohet.	<p>Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, faqja kryesore.</p> <p>https://durres.gov.al/category/bashkia/njoftime/ https://durres.gov.al/konsultimet-publike/</p>
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit në bashkëpunim me KNJKP i një “Përmbledhje të rekomandimeve dhe rezultateve të plota” që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti.

nga publiku deri në marrjen e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> • Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë dhe çdo këshilltari të bashkisë; • Shqyrtimi nga ana e Komisionit të mësipërm të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; • Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në planin e masave për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2026 të bashkisë Durrës. • Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; • Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; • Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; • Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	28.04.2026